



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
KËSHILLI TEKNIK

Nr. 355 Prot.

Tiranë, më datë 15.07.2026

VENDIM
Nr. 95, datë 15.07.2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 *“Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”*, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 *“Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Sqj”*, si dhe në Vendimin e KKTKM-së, Nr. 75 datë 19.02.2020 *“Për miratimin e llojeve të ndërhyrjeve me karakter mirëmbajtës të pasurive kulturore, sipas listës bashkëlidhur”*, i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektit, në mbledhjen e datës 15.07.2026, Këshilli Teknik:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të vlerësimit të potencialit arkeologjik hartuar në kuadër të projektit *“Godinë banimi dhe shërbimesh, 21 kate mbi tokë dhe 3 kate nëntokë”*, me vendndodhje në rrugën *“Dritan Hoxha”*, Bashkia Tiranë, me zhvillues subjekti **“2END” sh.p.k.**;
2. Gjatë procesit të zbatimit, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, i ndryshuar, neni 145, pika 1 dhe nëse ndeshen gjetje rastësore, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen sipas përcaktimeve të neneve 145 pika 2 - 147;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

